ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.9(399) SHTATOR 2021 ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

79-VJETORI

KONFERENCA E PEZËS, MESAZHE AKTUALE PËR SOT DHE TË ARDHMEN

FAQE 4-5

IN MEMORIAM

DY VJET PA GJENERAL RRAHMAN PARLLAKUN

Nga Halil RAMA

FAQE 2

SPECIALE

20 VJET NGA TRAGJEDIA E SHEMBJES SË KULLAVE BINJAKE

Ing.Vebi Musta Florida, USA

FAQE 6

Presidenti Meta vlerësoi me Dekoratën e lartë "Nderi i Kombit" (pas vdekjes), Komandantin legjendar të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

ME PROPOZIMIN E OBVL: GJENERAL NEXHIP VINÇANI "NDERI I KOMBIT"

10 Gusht 2021 - Presidenti Meta vlerëson Komandantin legjendar të LANÇ, Nexhip Vinçani me Dekoratën e lartë "Nderi i Kombit": "Merita dhe kontribute të shquara për organizimin dhe drejtimin e Luftës për çlirimin e Atdheut, për forcimin e Ushtrisë shqiptare, si luftëtar i përhershëm i lirisë dhe i demokracisë, si dhe njëri ndër themeluesit e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it"

DËSHMORËT NË RRËNJËT E KOMBIT

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

PREZANTIM ME LIBRIN

Erdhi dita dhe Organizata Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ-it dhe Dëshmorët e tjerë të Atdheut të dalë me librin me disa vëllime "Dëshmorët në rrënjët e kombit shqiptar". Në vëllimin e parë të dalë këto ditë nga shtëpia botuese ERMAL, nën kujdesin e kryetarit të OKDA, Dr. Gjergji Velo libri pas kaq vitesh pa dritën e botimit. Ky libër do të jetë me disa vëllime që do të botohen në vijimësi dhe do të trajtojë figurën e dëshmorit dhe të heroit të atdheut. Ka dhe njerëz që në ditët e sotme, si dhe drejtora të shtetit që thonë se nuk ka heronj Shqipëria.

(Vijon në faqen 11)

PANDEMIA

*Apeli i mjekut kardiolog, **Dr.Leonidha Peppo**, pas disa vëzhgimeve të kryera në Qendrën Shëndetësore Nr.4 Tiranë*

SI NDIKON COVID-19 NË ORGANET KRYESORETË TRUPIT DHE PSE DUHET TË VAKSINOHEMI?!

FAQE 9

LETRAT

DY TREGIME NGA SAKIP CAMI

- Bratko
- Plaku dhe flama

FAQE 7

HOMAZH

LAMTUMIRË JORGJI TERCA!

FAQE 8

OPINION

KËNGA GOTTINGEN DHE DEBATI NË RAJONIN E BALTOSUR TË BALLKANIT...

FAQE 8

LIBRI

URAN KALAKULLA, NJË JETË VUAJTJE DHE DINJITET NJERËZOR

Shpendi Topollaj

FAQE 10

IN MEMORIAM

Këshilli i Bashkisë Tiranë ka miratuar një rrugë me emrin "Gjeneral Rrahman Parllaku"

DY VJET PA GJENERAL PARLLAKUN

Nga Halil RAMA

Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur... Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut në këtë çerek shekulli të demokracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë

Dy vjet më parë më 15 shtator 2019 pushoi së rrahuri zemra e heroit legjendar Rrahman Parllaku – "Hero i Popullit" dhe "Nderi i Kombit". Një ditë më pas (16 shtator) ai u përcoll për në botën e përtejme me të gjitha nderimet që meritonte një burrështetas si Ai, me arkivolin mbi shtratin e topit dhe me 22 të shtënat në çastin e lamtumirës së tij.

Dy vjet që ai s'është fizikisht mes nesh, por shpirtërisht ai është me ne në çdo çast, pasi vepra e tij heroike e veshi atë me pavdekësi. Për të përjetësuar emrin dhe veprën e tij, duke konsideruar propozimin e Kryesisë së OBVL-së (Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it), Këshilli i Bashkisë Tiranë ka vendosur që segmenti rrugor që bashkon rrugën "Ali Demi" me rrugën "Petro Ni-ni Luarasi" të emërtohet "rruga 'Gjeneral Rrahman Parllaku'". Ky ishte vlerësimi më i mirë që iu bëhet qytetarëve të metropolit shqiptar në kuadrin e 100- vjetorit të shpalljes së Tiranës kryeqytet i Shqipërisë.

Dy vjet e gjysëm më parë, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me tit-ullin "Simbol i qytetit të Tiranës". (Në 95-vjetorin e lindjes, gjeneral Parllakut i është dhënë nga Presidenti i Republikës dekorata e lartë "Nderi i Kombit"). Kryebashkiaku Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë, ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike.

Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e "Heroit të Popullit" dhe "Nderit të Kombit", që bëri gjithçka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjener-alit janë plotësisht të merituara. Me gjeneral Parllakun ndihemi krenarë të gjithë. Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit familjar të trashëguar ndër shekuj.

Opinioni publik ka mirëpritur edhe librat e ndryshëm të shkruar nga gjenerali, siç është ai me titull "Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre", "Kosova, ëndrra e jetës sime", dhe librin me shtatë kapituj në 466 faqe "Një shekull në memorie". Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjemprehtësi të madhe, gjeneral Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi dhe ushtria jonë.

E veçanta e gjithë "ligjëratave" të tij në shtypin e kohës dhe në veprimtari promovuese të librave kushtuar Luftës Nacional-Çlirimtare e heronjve të saj, ka qenë gjykimi i tij tepër i saktë, konciz, real-ist, pa mllefe, pa paragjykime... Ai e ka vlerësuar gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacionalçlirimta-re, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit në tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë... si dhe këto vite të demokracisë e pluralizmit.

NGA JETA E KËTIJ MATUZALEMI NA ULET KËMBËKRYQ HISTORIA

Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur... Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut në këtë çerek shekulli të demo-kracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë. Dy vjet e gjysmë më parë, Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta, nëpërmjet një ceremonie të veçantë të zhvilluar në sallën "Skënderbeu" të institucionit të kreut të shtetit shqiptar, duke i uruar ditëlindjen e 100- të "Heroit të Popullit", veteranit të Luftës Nacional-Çlirimtare dhe të përndjekurit politik gjatë diktaturës komuniste, ndër të tjera tha se "i ngjizur në urtinë e odave lumjane dhe i burrëruar në Labëri, përgjatë një shekulli, gjeneral Rrahman Parllaku mbetet 'dëshmitar i gjallë' për të gjitha ngjarjet e një shekulli".

Kjo, sipas kreut të shtetit, për faktin se rrugëtimin 100-vjeçar, gjeneral Parllaku e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e paeksploruar plotësisht. "Ne nderohemi me ty, gjeneral! Pasi në jetën dhe veprën tuaj janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdhedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandantit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim. Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve", është shprehur Presidenti Meta. Në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe pro-gresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës.

Vështirë të përmbledhësh në pak radhë, në kuintesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që ngjitej nga Novosej i Kukësit në tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndresës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrit të dobishëm në stigmën e "njeriut të rrezik-shëm", ekstreme këto që provokuan në personalitetin e tij qëndrime dhe vlera të larta politiko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes. Këtë volum ideor dhe estetik e përcjell përgjatë shekullit të jetës së tij një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje ko-herente dhe një vizion largpamës dhe perspektiv.

HEROI QË FITOI DUKE MERITUAR LAVDINË DHE PAVDEKËSINË

Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut, atë e përshkon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e tij është një shëmbëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigant hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë. Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përulën gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përballjes në gjyqe ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj.

Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit, ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektuali patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime. Ai është një model i ardhur nga gjenocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja.

Mbi 20 vjet në krye të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL), me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike, duke dhënë një ndihmesë të vyer në emancipimin politiko-shoqëror e demo-kratik të shoqërisë. Si një lundërtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bën këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organ-izata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

CEREMONIA

Presidenti Meta vlerësoi me Dekoratën e lartë "Nderi i Kombit" (pas vdekjes), Komandantin legjendar të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

ME PROPOZIMIN E OBVL: GJENERAL NEXHIP VINÇANI "NDERI I KOMBIT"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

I jep

NEXHIP VINÇANIT (PAS VDEKJES)

DEKORATËN "NDERI I KOMBIT"

"Në vlerësim të kontributit të shquar në mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit shqiptar.
I dalluar për guximin, përkushtim dhe aftësi drejtuese gjatë LANÇ-it, si njëri prej luftëtarëve të parë të njësiteve dhe çetave partizane, deri komandant ushtarak i Brigadës IV Sulmuese.
Për cilësitë e spikatura në fuqizimin e modernizimin e ushtrisë shqiptare, për kurajën qytetare dhe mbështetjen e proceseve demokratike, si dhe njëri ndër themeluesit e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it".

Nr. Dekreti 13192
Tiranë, më 09.08.2021

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META

10 Gusht 2021 - Presidenti Meta vlerëson Komandantin legjendar të LANÇ, Nexhip Vinçani me Dekoratën e lartë "Nderi i Kombit": "Merita dhe kontribute të shquara për organizimin dhe drejtimin e Luftës për çlirimin e Atdheut, për forcimin e Ushtrisë shqiptare, si luftëtar i përhershëm i lirisë dhe i demokracisë, si dhe njëri ndër themeluesit e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it"

◦ !"

Me anë të një ceremonie solemne, Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta, me propozimin e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL) vlerësoi me Dekoratën e lartë "Nderi i Kombit" (pas vdekjes), Komandantin legjendar të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Gjeneral-Major Nexhip Vinçani, me motivacionin:"Në vlerësim të kontributit të shquar në mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit shqiptar. I dalluar për guximin, përkushtim dhe aftësi drejtuese gjatë LANÇ-it, si njëri prej luftëtarëve të parë të njësiteve dhe çetave partizane, deri komandant ushtarak i Brigadës IV Sulmuese. Për cilësitë e spikatura në fuqizimin e modernizimin e ushtrisë shqiptare, për kurajën qytetare dhe mbështetjen e proceseve demokratike, si dhe njëri ndër themeluesit e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it".

Në këtë ceremoni merrnin pjesë drejtuesit e OBVL: kryetari kolonel So-

Av.Msc Halil Rama - "Mjeshtër i Madh", nënkryetarët e OBVL Muharrem Gjoka - "Mjeshtër i Madh" dhe anëtarët e kryesisë së OBVL: Tatjana Parllaku, Shuaip Methasani, Liljana Muçaj, si dhe Prof. asoc.dr.Bernadrd Zotaj – Kryetar i Shoqatës së Historianëve Ushtarakë të Shqipërisë dhe Thoma Konduri – Kryetar i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në rezerve të Shqipërisë. E dhjetra familjarë e të afërm të gjeneral Vinçanit.

Në fjalën e Tij përshëndetëse drejtuar familjarëve, bashkëluftëtarëve dhe anëtarëve të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it, Kryetari i Shtetit u shpreh:

"Jam i lumtur të jemi së bashku në këtë ceremoni solemne të dekorimit të Gjeneral Nexhip Vinçanit, një prej figurave më të ndritura të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, por dhe një prej drejtuesve ushtarakë më të aftë në fuqizimin dhe modernizimin e ushtrisë shqiptare.

Gjeneral Vinçani ka qenë përherë, në kohën dhe në vendin e duhur, në çdo betejë dhe përpjekje për të mbrojtur lirinë e shqiptarëve dhe pavarësinë e Atdheut.

I lindur në një familje të dëgjuar luftëtarësh e patriotësh, si bir i atdhetarit të shquar Kahreman Vinçanit ai u përkund, u mbrujt dhe u edukua me dashurinë për popullin, për vatanin dhe aspiratën shqiptare për liri.

Jeta e tij është një kronikë heroike përpjekjesh dhe përkushtimi për atdheun.

Që në hapat e parë të arsimimit të tij në Liceun e Korçës, në Shkollën Mbretërore Ushtarake dhe gjimnazin e Shkodrës, i riu Nexhip Vinçani premtonte të bëhej një patriot i shquar në mbrojtje të kulturës, traditave dhe të identitetit kombëtar.

Formimi tij atdhetar dhe shoqëria me bashkëmoshatarë të tjerë antifashistë si Qemal Stafa e Sadik Bekteshi, e vendosi në krye të lëvizjeve antifashiste.

Ndaj, edhe pse ishte student në Romë ai iu përgjigj kushtrimit të Atdheut.

Që në fillim të pushtimit Nexhipi së bashku me të atin, vëllezërit dhe të gjithë të afërmit e tyre rrëmbyen armët dhe u përfshinë në luftën e madhe patriotike kundër pushtuesve nazi-fashistë.

Është e vështirë të përmblidhet në një përshëndetje veprimtaria luftarake, betejat dhe kontributi i Nexhip Vinçanit në epopenë e çlirimit të vendit.

Gjeneral Nexhip Vinçani ishte një luftëtar i sakrificave vetëmohuese dhe një drejtues ushtarak i talentuar, me burrëri e cilësi të rralla për karakterin e tij.

Pjesëmarrja si delegat në Konferencën e Pezës e rrit dhe më tej figurën dhe personalitetin e tij!

Si Komandant i Përgjithshëm i Shtabit të Qarkut të Korçës, ai ngriti dhe udhëhoqi në beteja mbi dhjetëra çeta e brigada partizane në krejt atë trevë të shquar.

Ai do të njihej më tej në gjithë Shqipërinë, nga Jugu në Veri si Komandant legjendar i Brigadës IV Sulmuese.

Komandant Vinçani mori pjesë në 255 ditë luftime. Ai udhëhoqi me sukses luftimet partizane në operacionet e Dimrit e të Qershorit të vitit 1944, dhe hyri fitimtar në Tiranën e lirë si Zëvendëskomandant i Shtabit për çlirimin e kryeqytetit.

Të nderuar të pranishëm, komandantët e vërtetë njihen në luftë e në furtuna, por edhe nga karakteri i pathyeshëm dhe idealist!

Pas çlirimit, Gjeneral-Major Vinçani do t'i përkushtohej artit ushtarak, forcimit e modernizimit të ushtrisë tonë. Ai do të shquhej për ekspertizën e lartë, respektimin e figurës së ushtarakut, si dhe aftësinë e veçantë drejtuese për të ruajtur të paprekur territorin e Republikës së Shqipërisë.

Por me sa duket këto vlerat, atdhetarizmi dhe kontributi Nexhip Vinçanit në çlirimin e vendit dhe fuqizimin e Ushtrisë sigurisht që i bënin hije dikujt dhe ashtu edhe si shumë figura të tjera të shquara të Luftës Antifashiste, dhe më pas edhe të ushtrisë sonë, edhe ai u persekutua për t'u burgosur padrejtësisht.

Vendosja e demokracisë bëri që Gjenerali i nderuar të integrohej e të zinte vendin e merituar në hierarkinë e vlerave shoqërore.

Në një nga përvjetorët e Brigadës IV gjenerali u kthye përsëri në Korçë, u prit me shumë dashuri e respekt si dikur nga banorët, dhe u foli bashkëluftëtarëve të tij si komandanti i tyre i dikurshëm.

Në këto vite, me shokët e tij të luftës, ai të krijoi Organizatën e Bashkuar të Veteranëve LANÇ-it për të mbrojtur idealet e vërteta partizane për liri e demokraci, si dhe për të edukuar brezat e rinj me dashurinë e pastër për Atdheun dhe dëshmorët e tij.

Të dashur familjar dhe veteranë, heronjtë e vërtetë duken më të mëdhenj me kalimin e viteve!

Ndaj sot jemi mbledhur për të vlerësuar Gjeneral Nexhip Vinçanin me De-

koratën e lartë "Nderi i Kombit", për të gjitha meritat e shquara të tij, në organizimin e drejtimin LANÇ-it, për forcimin e Ushtrisë shqiptare, dhe si luftëtar i përhershëm i lirisë dhe i demokracisë!

Ky nderim është njëkohësisht vlerësim për gjithë luftën, vetëmohimin dhe përpjekjet e bijve më të mirë të këtij vendi për një Shqipëri të lirë, për një Shqipëri më të mirë por edhe shprehje respekti për të gjithë ata të cilët mbeten me jetën e tyre një simbol i integritetit dhe i dinjitetit tonë si shqiptarë!"

KUJTIME

Konferenca e Pezës, mesazhe aktuale për të sotmen dhe të ardhmen

Gjeneral Rrahman Parllaku: Konferenca fashizmit, ja momenti kur tradhtoi Balli,

Gjashtë vjet më parë, gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe "Nderi i Kombit" do të konsideronte Konferencën e Pezës si një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar. Në një intevistë ekskluzive për gaztën "SOT", ish kryetari i OBVL shprehet se "Konferenca e Pezës bashkoi gjithë shqiptarët, pa dallim feje dhe ideje, në luftën kundër nazifashistëve. Rrahman Parllaku, gjenerali që luftoi fashizmin dhe sfidoi komunizmin dhe një prej figurave më qendrore dhe emblematike të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, është shprehur se Konferenca e Pezës i dha karakter kombëtar luftës kundër nazifashizmit, duke e renditur Shqipërinë në krahun e duhur të koalicionit të madh antifashist. Ai ka deklaruar se jo të gjithë mbetën të kënaqur me Konferencën e Pezës, por aty nisi dhe mirëorganizimi ushtarak i vendit, për t'i bërë ballë forcës armike. Gjenerali ka rrëfyer me detaje se si u krijuan çetat partizane dhe si u bë organizimi i ushtrisë. Parllaku ka folur dhe për Konferencën e Mukjes, e cila erdhi pas asaj të Pezës. Por, ai ka deklaruar se kjo konferencë erdhi për të ndarë pushtetin, pasi nazifashistët po shkonin drejt kapitullimit. Sa i përket rolit të Ballit Kombëtar, Gjeneral Parllaku është shprehur se ata kanë qenë bashkëpunëtorë të pushtuesve.

-Gjeneral Parllaku, si protagonist i lëvizjeve të asaj kohe dhe i luftës, çfarë impakti pati Konferenca e Pezës në rezistencën ndaj nazifashistëve?

Konferenca e Pezës është si gjithë konferencat, kongreset që kanë ndodhur në historinë e kombit tonë. Gjithnjë kur ka pasur nevojë kombi, janë bërë kuvende, janë mbledhur njerëzit dhe kanë vendosur për fatet e vendit. Përmendim Kuvendin Lidhja e Prizrenit, që është kulmi, Lidhja e Pejës dhe kuvende të tjera të vendit tonë. Edhe Konferenca e Pezës lindi si nevojë e bashkimit të popullit; pa bashkim nuk mund të thuash që e do fitoren. Bashkimi është baza e fitores! Dhe Konferenca e Pezës lindi si nevojë e bashkimit kombëtar për luftën antifashiste. Iniciativën, patjetër që në radhë të parë e mori Partia Komuniste, pasi ishte bërë një lëvizje e organizuar në vendin tonë në luftën kundër fashizmit. Atë meritë e ka. Gjeti gatishmërinë e shumë personaliteteve politike, kombëtare, që t'i bashkoheshin konferencës dhe morën ato vendime që konferenca pati: Për një Shqipëri indipendente, të pavarur dhe të pandashme. Momenti ishte tamam kur lëvizja kishte filluar, sidomos ana rinore. Gjithnjë, rinia është ajo që merr flakë më shpejt, mobilizohet më shpejt. Lëvizja në Shqipëri ka lindur në shkollat e mesme, ato u bënë bazë për lëvizjen kombëtare. Që më 7 prill shkollat u ngritën në këmbë, në protesta. Pas 7 prillit, shkollat iu kundërvunë dhe drejtorëve italianë, gjuhës italiane dhe pushtimit. Këto shkolla krijuan atë ndjenjën e lëvizjes dhe bashkë me to morën dhe formën e organizimit jo të plotë. Konferenca e Pezës hodhi bazat e një organizimi kombëtar të lëvizjes. Kështu do ta quaj që, bashkimi kombëtar i ka themelet në Pezë. Personalitetet që kanë marrë pjesë dihen, kanë qenë patriotë, intelektualë, si njerëz të tjerë që kanë pasur ndjenja kombëtare për të luftuar kundër fashizmit. Pas Konferencës së Pezës, lëvizja mori një zgjerim tjetër. Filluan të krijohen baza nga Jugu në Veri, dhe vetëm gjatë vitit '42 janë ngritur 22 çeta partizane nga Konispoli në Tropojë. Filluan të krijohen Këshillat Antifashistë Nacional Çlirimtarë, që u bënë një bazë për lëvizjen në Shqipëri. Filloi të marrë formë organizimi ushtarak. Nuk po mbeteshin vetëm çetat partizane, por filluan të krijohen çetat territoriale, si dhe ato të fshatit. Filluan të krijohen batalionet e organizuara. Pra, lëvizja filloi të marrë frymë dhe të hapet në të gjithë vendin.

-Cilat ishin vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Pezës?

Po e them me dy fjalë: Bashkim pa dallim feje, krahine dhe ideje! Por në rezolutë thuhet: "Shqipëri e pavarur, indipendente, e pandashme dhe demokratike". Këto janë të rezolutës, nga aq sa më kujtohen tani. Ky është qëllimi, pra të kemi një Shqipëri të lirë, të pavarur, të pandashme, indipendente dhe demokratike.

-A arriti Konferenca që të bashkojë përfaqësuesit e të gjitha grupeve politike?

Atje u përfaqësuan të gjitha grupet. Hysni Lepenica ishte nga Balli Kombëtar. Pati dhe persona të tjerë si Bumçi, Qafmolla, Haxhiu, etj., të cilët ishin patriotë të vendosur për luftën kundër fashizmit. Partia u përfaqësua nga Ymer Dishnica, që ishte kryesori. Por, çfarë realisht solli konferenca? Konferenca solli zgjerimin e Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare në të gjithë vendin. Jehona e Konferencës së Pezës shkoi kudo në Shqipëri dhe predispozicioni i njerëzve bëri që brenda vitit '42 të krijohen 22 çeta partizane. Kjo i dha hov tjetër luftës. U krijuan njësitë guerile në qytete, çetat partizane në krahina, pra pati një shtrirje të luftës. Si u prit? Populli ishte i predispozuar për luftën, e tregoi që kur erdhi fashizmi. U ngrit gjithë populli në këmbë, tjetër gjë që nuk e drejtoi Zogu, por populli ishte i predispozuar. Unë në atë kohë jam ndodhur në Selenicë të Vlorës dhe u ngritën të gjitha krahinat, edhe unë bashkë me ta, zbritëm për të kërkuar armë. Qëndruam tre ditë në rrugët e Vlorës. Demonstrata vinte e shkonte me thirrje: Armë, armë! Pra, populli ishte i gatshëm për të luftuar dhe mbrojtur vendin. Drejtimi i Zogut mungoi dhe nuk u arrit. Megjithatë, nuk u shkel Shqipëria pa gjak. Musolini tha se do të na presin me lule, këtu u pritën me plumba. Sado pak, qoftë një rezistencë në Vlorë, ajo e Durrësit, qoftë e Shëngjinit, qoftë e Sarandës, pati përpjekje, ata njerëz që ishin për luftë u përpoqën. Pra, predispozicioni ishte, rinia u bë nismëtare, bashkë me profesorët. Pjesa e mirë e profesorëve ngritën shkollat në protesta, në demonstrata. Këtu fillon historia, se lufta fillon në qytet, shkon në fshat, pastaj kthehet në qytet. Edhe tek ne, filloi nga njerëzit e kulturës, pastaj vazhdoi me fshatin dhe në të gjithë vendin. Po të marrim gjendjen në Shqipëri, lëvizja mori hov të veçantë. Pezën e kemi në shtator dhe më pas filloi një situatë tjetër. U krijuan reparte partizane që vepronin brenda qarkut. Nëse çeta mbetej brenda komunës dhe krahinës, u krijuan batalionet. Batalionet vepronin në të gjithë qarkun. Në prill, maj, qershor, në të gjithë Shqipërinë, lindën batalionet partizane. Lindi lufta, u zhvillua ushtria. Mori karakter të organizuar. Duke marrë lufta karakter të organizuar, çoi në krijimin e Shtabit të Përgjithshëm. Duhej të kishte një qendër ta drejtonte. Deri këtu vijmë me luftën e drejtuar nga komitetet e partisë në qarqe.

-Kur filluan devijancat e para pas konferencës dhe çfarë kundërshtish pati?

Devijanca, mendime e kundërshti ka pasur, që te konferenca dhe pas konferencës. Por nisën kryesisht kur u krijua Balli Kombëtar. Ka pasur edhe njerëz të tjerë që kanë pasur pikëpamje ndryshe. Nuk mund të them se u pajtuan Bajraktarët e Veriut me konferencën, që të jemi realistë. Një pjesë e mirë u bashkua me okupatorin. Një pjesë tjetër mbeti neutrale dhe nuk mund të thuhet që menjëherë konferenca gjeti mbështetjen e të gjithëve. Konferenca erdhi duke u rritur. U ngritën repartet partizane, u shtri lufta, u rrit influenca dhe ndikimi për të përfshirë gjithë popullin. Kjo çoi në Konferencën e Labinotit, në krijimin e Shtabit të Përgjithshëm. Që këtu Lufta Nacional Çlirimtare merr karakter tjetër. Krijohen komandat e qarqeve. U krijua Brigada e Parë, batalionet ishin pothuajse në të gjitha qarqet. Që nga Shkodra në Tropojë, Kukës deri në Jug, ku qe lëvizja më e zhvilluar.

-Pas Konferencës së Pezës erdhi ajo e Mukjes...

Përpara se të shkojmë te Konferenca e Mukjes, duhet të shohim se si shkoi lëvizja nga Peza deri në Mukje. Mukja vjen në prag të kapitullimit të Italisë, kur Lufta Nacional Çlirimtare ishte përhapur në të gjithë Shqipërinë. Në Shqipëri ekzistonin krahina të lira, si krahina e Lumit të Vlorës, Kurveleshit, Zagorisë, Pezës. Janë gjithë ato operacione të italianëve për Pezën dhe Peza ishte e lirë, këtu në afërsi të Tiranës. Pra kur vjen Konferenca e Pezës, në Shqipëri ke njësi të mëdha. Krijohet Brigada e Parë, ke batalione në luftë, ke këshilla nacionalçlirimtare të krijuara në të gjithë vendin, ke një hapësirë tjetër të luftës. Mukja vjen kur po kapitullonte Italia dhe po fillonte lufta për pushtetin e ardhshëm. Balli Kombëtar dhe partia, që ranë dakord megjithëse u prishën, kishin shpresën se mos anglezët zbarkojnë në Shqipëri. Duke qenë se kishin ardhur në Itali, mund të vinin dhe në Shqipëri, ndërsa gjermanët ishin të preokupuar për ta mbrojtur bregdetin. Këtu lind që Balli dhe pjesa tjetër e të ashtuquajturve nacionalistë ishte që po të vinin anglezët, të ishim dhe ne në pushtet. Partia Komuniste mori pjesë, mirëpo kur e pa që këtu mund të vinte ndarja e pushtetit, Enveri për pushtetin mund të vriste dhe Mulla Halilin. Pra, pse u prish Mukja? U prish për pushtetin. Edhe njëra anë ishte për pushtetin, edhe ana tjetër ishte për pushtet. Se në fund të fundit edhe lufta për pushtet bëhet. Bëhet për çlirim, por bëhet dhe për pushtet.

-Domethënë, grupi i Ballit dhe nacionalistët pritën dhe qëndruan si neutralë dhe pritën se kush do dominojë...

Gjithë parullat dhe thirrjet e tyre kanë qenë që po sakrifikohet rinia, të presë, vijë koha dhe të ngrihemi. Por kë të prisnim? Kurse ne ishim, u shkel vendi? Lufta duhet të vazhdojë. Kur je i zaptuar nuk ka më se çfarë të presësh për çlirimin.

-Realisht, Balli Kombëtar, a ka bashkëpunuar me pushtuesin dhe në çfarë forme?

Unë me organizatën time, komandantin e Ballit për Jugun, Hysni Lepenicën, e kam bërë dëshmor me 30 vetat që janë vrarë atje. Pse? Sepse sa qenë italianët në Shqipëri, sa qe Hysni Lepenica komandant i Ballit për Jug-

KUJTIME

e Pezës bashkoi shqiptarët kundër Mukja ishte për ndarjen e pushtetit

un, ne nuk kemi pasur përplasje me Ballin. Përkundrazi, në luftë kundër mercenarëve të Halil Alisë, Hysni Lepenica ka qenë me ne bashkë në luftë. Pastaj, debate ne kishim më shumë, ata kishin më pak, ajo ishte luftë popullore. Edhe ne një çetë kishim kur luftuam me ata, por erdhi gjithë populli në mbështetje të luftës. Sa ishin të këtij, unë nuk i numëroj, por di që Hysni Lepenica ishte bashkë me Hysni Kapon në luftë kundër mercenarëve. Përzumë karabinierinë nga Selenica, Hysni Lepenica ishte me ne. Luftuam në Patos, Hysni Lepenica ishte me ne. U vranë Gostinishti dhe heronjtë tanë, ndërsa atyre ju vra Jashar Cakrani. Pra, Hysni Lepenica në këtë luftë është bashkë me ne. E vranë italianët. Pse vajti e si vajti. Ai vajti për të marrë armë siç vajtëm të gjithë. Kur u prishëm me Ballin ne? Kur erdhi Kadri Cakrani, komandant i Ballit, një kriminel që ka bashkëpunuar me gjermanët. Ka edhe dokumente. E kanë furnizuar me armë gjermanët. Është një periudhë tjetër. Deri në Mukje, ne nuk kemi rënë në luftë me Ballin, megjithëse ballistët na kanë vrarë dy veta. Ne nuk hapëm luftë. A kanë bashkëpunuar? Kanë bashkëpunuar. Ne kemi luftuar me ta, prandaj nuk mund të mohohet. Pse shkuan dhe si shkuan, justifikimet le t'i bëjnë ata. Ne dimë që kemi luftuar dhe kundër tyre. Kur u kthyem në krahinën e Vlorës, gjermanët kishin ngritur Këshillat e Ballit. Erdhëm ne, i përzumë gjermanët bashkë me këshillat. Lufta është bërë. Justifikime mund të bëhen plot.

-Pra, cili ishte roli i Mukjes në luftën për pushtet?

Mukja ishte luftë për pushtet dhe ne prandaj e dënuam. Edhe jugosllavët mund të kenë ndikuar, nuk mund të them që nuk ndikuan. Jugosllavët nuk ishin për një Shqipëri etnike. Trojet shqiptare kush i kishte zaptuar? Ata i kishin zaptuar dhe nuk mund të ishin për një Shqipëri etnike, siç u shpreh Mukja. Patjetër që ndikimi i tyre është.

-Flitet që partizanët dhe komunistët kanë bashkëpunuar dhe me jugosllavët. Si arritën rusët dhe Jugosllavët për të pasur një ndikim të madh për të diktuar më pas dhe se kush do të drejtonte vendin?

Ne e filluam Luftën Nacional Çlirimtare me gjithë kampin imperialist. Në qoftë se ministrat e Jashtëm deklaruan se e njohim luftën e popullit shqiptar, megjithatë anglezët mbajtën një kushtëzim që çështja e kufirit do të shqyrtohej pas lufte. Pse? Sepse i kishin dhënë mbretit grek premtime. U përpoqën grekët në Konferencën e Paqes, por u rrëzua teza e tyre për të marr pjesën e Jugut. Pra, Lufta Nacional Çlirimtare u njoh nga tre të mëdhenjtë. Pse anglezët na mbështetën neve? Ata ishin të interesuar që të zhvillohej lufta në Shqipëri. Ashtu siç ndihmuan jugosllavët. Më antikomunist se Çërçili s'ka patur, por djali i tij ishte pranë Titos. Pse ishte pranë tij? Lufta është llogari. Sa njerëz të mirë do vriten dhe sa do vriten të tjerë. Ai që lufton gjen dhe mbështetje. Dhe pse mbështetjen me armë, me flori dhe veshje na i dhanë anglezët? Sepse ne luftuam. Kjo luftë u kursente gjak anglezëve, se ishte luftë që mbante divizionet të shkonin në divizionin anglez. Gjermanët dhe italianët, forcat që kishin në Shqipëri do i çonin atje. Prandaj, mbështetja e Luftës Antifashiste është interesi i aleancës antifashiste të popujve. Arsyeja që ne u bëmë pjesë e saj, ishte Lufta Nacional Çlirimtare. Pa Luftën Nacional Çlirimtare nuk do të ishim pjesë. Nuk valëvitej flamuri ynë ditën e 9 majit as në Paris, as në Londër, krahas flamujve fitimtarë. Pra, lufta po na çon drejt Evropës. Sot duam të shkojmë në Evropë dhe nuk po shkojmë dot, ndërsa ne me luftë dhe vajtëm në Evropë. Pra, me luftën tonë ne çliruam vendin, ndihmuam Kosovën, ndihmuam popujt e Jugosllavisë dhe aleancën antifashiste dhe për këtë krenohemi ne me luftën. Nuk krenohemi me gjera të tjera, sepse nuk sollëm demokracinë por diktaturën, nuk sollëm bollëkun, por varfërinë.

-Cili ishte roli i Partisë Komuniste në luftë?

Pavarësisht se ne e kemi dënuar, luftën fillimisht e nisi Partia Komuniste. Derisa u krijua Shtabi i Përgjithshëm, drejtimi ka qenë. Këtë nuk mund t'ia mohosh në luftë. Është tjetër gjë të ndash diktaturën me luftën. Lufta është e lavdishme. Jo më e lavdishmja, se atëherë mohohet Skënderbeu që zhvilloi 22 beteja kundër turqve. Mohojmë Lidhjen e Prizrenit, mohojmë ngritjen e flamurit. Pa atë ngritjen e flamurit, pa ato 4 mijë kilometrat e Ismail Qemalit nuk do kishte shtet shqiptar. Kurdët janë mbi 50 milionë dhe sot nuk kanë shtet. Ne aq sa qemë, ai krijoi shtetin. Dhe pa shtetin e Ismail Qemalit, që flasim ne tani 28 apo 29, pa 28 Nëntorin nuk do të kishte 29 Nëntor, se nuk kishte Shqipëri. Një pjesë do ta kishte marrë Serbi, një pjesë do ta kishin marrë grekët, do mbetej një pjesë në varësi të Italisë dhe Shqipëria nuk do të ekzistonte, atëherë ku do të kishte luftë? Do ishim kolonizuar nga italianët.

-Vetë Enver Hoxha, çfarë roli kishte në Konferencën e Pezës?

Enver Hoxha nuk ka qenë komandant i ushtrisë, se ngatërrohet. Komandant ka qenë Spiro Moisiu, zëvendës ka qenë Dali Ndreu. Enver Hoxha është bërë komandat i ushtrisë kur Shqipëria çlirohet. Përmeti e bën komandant. Ai është udhëheqës politik i luftës, që ishte në krye të Partisë Komuniste. Nuk ia mohon njeri që ka qenë në krye të Partisë Komuniste dhe ka qenë udhëheqës politik. Por duhen ndarë gjërat. Ata që janë nostalgjikë të Enverit dhe e quajnë komandant. Komandat ka qenë Spiro Moisiu dhe Enveri ka qenë udhëheqës politik. Këtu është problemi tek ne, se duam të ndërtojmë historinë mbi persona.

-Çfarë ndodhi në Konferencën e Përmetit që Hoxha u bë komandat?

Në Konferencën e Përmetit, Spiro Moisu u bë shef i shtabit dhe ai u bë komandant. U krijuan armatat dhe divizionet. Ishim në çlirim. Kongresi i Përmetit është prelud i çlirimit të vendit. Kush do të ishte festa jonë e çlirimit? Do të ishte çlirimi i kryeqytetit. Gjithë bota e ka, po u çlirua kryeqyteti, çlirohet vendi. Gjërat duhen parë historikisht.

-A janë përkujtuar në mënyrën e duhur heronjtë e luftës?

70-vjetori i çlirimit nuk u festua ashtu siç e meritonte. Kërkesa e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve ka qenë. Çfarë bëhet me varret e dëshmorëve, pasi heronjve nuk u dihen emrat? Çfarë u bë? U dhanë 100 milionë lekë dhe shkuan për aheng për rininë, por nuk shkuan te lapidarët, monumentet apo varret e dëshmorëve. A flitet për 70-vjetor të çlirimit? Ai 70-vjetor meritonte tjetër përkujtimore. Kjo nuk u bë siç duhej. Edhe sot e kësaj dite, ne ngulim këmbë. Na vjen mirë që ky kryetari i bashkisë të paktën ka premtuar se do t'i rregullojë varret dhe shpresojmë se do t'i rregullojë. Kur shkuam bashkë me Komitetin e Kosovës, ata nuk gjetën varret e dëshmorëve, të Emin Durakut, Stavalecit, etj., që janë heronj dhe nuk gjen emrat e tyre te Varret e Dëshmorëve. Kur nuk gjenden emrat e dëshmorëve, mendoni se çfarë janë pllakat e tjera! Kur vijnë njerëzit në festën e çlirimit, ata që duan shkojnë të vizitojnë varret. Shohin cili është kujdesi për dëshmorët dhe për luftën. Pra, ne kemi pretendime dhe shpresojmë që edhe këto konferencat dhe përkujtimoret të mos bëhen përkujtimore partie, të jenë përkujtimore shteti. Ka bashki, ka qeveri. Kur bëhen përkujtimoret bëhen shtetërore, se nuk i takojnë një qeverie, i takojnë popullit. Populli nuk shikon partitë, se partitë janë rreth 30. Ata që vijnë me fotografinë e Enverit, edhe vijnë se është parti legale.

-A duhet që Enver Hoxhës t'i hiqen dekoratat e luftës?

Dy herë e kam kërkuar. I vdekurit nuk gjykohet, si gjyq. Por, Parlamenti ka të drejtën t'i heqë titujt dhe gradat. Presidenti nuk i heq dot, se ka të drejtë t'i japë, jo t'i heqë. Kurse Parlamenti e ka këtë të drejtë. Unë dy herë i jam drejtuar, por bien në vesh të shurdhët se ata që janë në pushtet dhe nuk e kanë me interes t'ia heqin. Unë e kam kërkuar, pa marrë parasysh që nostalgjikëve të Enverit nuk u ka ardhur mirë.

Kliti Topalli –Gazeta "SOT",
15 shtator 2015

Meta: Pezë do të thotë Shqipëria mbi të gjitha

Në një nga përvjetorët e Konferencës së Pezës, Presidenti i Republikës, Ilir Meta është shprehur se: "Pezë do të thotë bashkim, kushtrim dhe qëndresë, pa dallim feje, krahine dhe ideje në mbrojtje të interesit kombëtar", është shprehur Meta.

"Mesazhet që përcjell edhe sot, Konferenca e Pezës janë më aktuale se kurrë për të lënë mënjanë ndasitë e interesat afatshkurtra, dhe për t'u bashkuar kundër një pushtimi të ri nga një sekt e një bandë oligarkësh që kanë uzurpuar institucionet dhe kanë marrë peng të ardhmen e çdo shqiptari dhe atë europiane të vendit tonë", ka nënvizuar Meta.

"Peza është një amanet: Besa-besë për të shpëtuar Shqipërinë! O sot o kurrë", ka përfunduar Meta.

Më 16 shtator të vitit 1942 u mbajt Konferenca e Pezës, e cila pati për qëllim organizimin e forcave të ndryshme politike në një luftë të përbashkët kundër Italisë fashiste. Më vonë ky organizim mori emrin Fronti Nacional-Çlirimtar.

SPECIALE

Inxhinieri nga Bulqiza Vebi Musta, studim për tragjedinë më të madhe në historinë e njerëzimit

20 vjet nga tragjedia amerikane e shembjes së kullave binjake

Ing.Vebi Musta
Florida, USA

Këtë 11 shtator mbushen 20 vjet nga tragjedia më e madhe në historinë e njerëzimit botëror, goditja e kullave binjake të ashtuquajtura ëorld Trade Center ose Qendra Ndërkombetare e Tregtisë në New York të SHBA nga terroristët islamikë. Me 11 Shtator 2001, njëkohësisht në të njejtën orë u goditën, Qendra e Ushtrise Amerikane në ëashington dhe Shanksville në Pensilvania. Nga kjo trgjedi që ndodhi brenda një ore e 15 minutash humbën jetën mbi 3058 njerëz dhe u lënduan më shumë se 60.000 të tjerë, nga SHBA dhe shumë vende të tjera nga e gjithë bota.

SI E KUJTOJ UNË ATË DITË, VËRTET TË TRISHTUESHME?

Mëngjesin e 11 Shtatorit 2001 po punoja në një fabrikë për prodhimin e kondicionerëve, sistemit të ngrohjes dhe ftohjes në Florida të SHBA. Aty nga ora 10.00 një shok pune, që ishte me origjinë nga Vietnami, me telefon në dorë dhe me të madhe thërret: ëar in New York, ar in New York që do të thotë "luftë në New York".

Të gjithë ndaluam punën dhe u grumbulluam rreth tij, dhe me të vërtetë pamë tym dhe flakë në mes të New Yorkut. Pas disa minutash bie zilja e punës për pushim të jashtëzakonshëm. Grumbullohemi të gjithë punonjësit, mbi 250 veta që punonim në atë fabrikë në mbledhje me përgjegjësin e saj, i cili na tregon për ngjarjen e rëndë. Ai na thotë se është sulm terrorist por neve nuk duhet të shqetësohemi se çdo gjë është nën kontrollin e shtetit federal dhe duhet t'i kthehemi punës pa ndonjë shqetësim për ne. Ashtu vepruam dhe punuam deri sa mbaroi turni, por me ankth të papërshkruar deri sa u kthyem në shtepi.

Si çdo njeri tjetër edhe unë vazhdimisht kam menduar, lexuar dhe studiuar për këtë ngjarje tragjike, dhe sot pas 20 vitesh, në përkujtim të saj kam ndërtuar një projekt me një pamje nga sulmi terrorist me avionët e pasagjerëve mbi ndërtesat 110 katëshe të kullave binjake dhe rreth e rrotoll tyre. Kam shkruar me dorë të gjithë emrat e viktimave e përbri tyre moshën në momentin e goditjes. Këtë projekt, të përgatitur në një kornizë me përmasat 106 cm x 91 cm ose 42 inch x 36 inch kam menduar t'ja dhuroj Muzeut Kombëtar të viktimave të 11 shtatorit 2001, të ndërtuar në New York.

PËR 1 ORË E 15 MINUTA RRËMBEHEN NGA TERRORISTET DHE RRËZOHEN 4 AVIONË PASAGJERËSH

Në këtë përvjetor të kësaj masakre po i rikujtojmë lexuesit kohën kur ndodhi tragjedia me rrëmbimin e avionëve dhe goditjen e dy ndërtesave më të larta në SHBA, në Qendrën e Ushtrisë amerikane Pentagon dhe në qytetin e Pennsilvania të shtetit Filadelfia.

11Shtator 2001 - Ora 8.45 e mengjesit sipas orës americane. Avioni amerikan American Airlines 11 tip Boing 767 që ishte nisur nga Boston i shtetit Massachusetts për në Los Angeles, California me 81 pasagjerë, 9 punonjës shërbimi dhe 2 pilotë në bord rrëmbehet në fluturim nga terroristët brenda avionit dhe godet godinën veriore të Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë (ëTC);

Ora 9.03 e mëngjesit. Avioni United Airlines 175 që ishte nisur nga Boston për në Los Angeles me 57 pasagjerë, 7 punonjës shërbimi dhe dy pilotë në bord rrëmbehet në fluturim nga terroristët dhe godet godinën Jugore të Qendrës Ndërkombëtare të Tregtise (ëTC);

Ora 9.43 e mengjesit. Avioni American Airlines 77 që ishte nisur nga airoporti Dulles ëashington, DC për në Los Angeles me 58 pasagjerë dhe 4 punonjës shërbimi e 2 pilotë në bord përpiqet të godasë Qendrën e Ushtrisë amerikane në Pen-

(Vijon në faqen 7)

TRE HERONJTË SHQIPTARË TË TRAGJEDISË SË 11 SHTATORIT 2001

Dua të bëj me dije se në këtë tragjedi kanë humbur jetën edhe 3 shqiptarë, të cilët kanë qenë punonjës të Qendrës Ndërkombëtare tëTregtise Neë York. Rrok Camaj ishte 60 vjeç, nga fshati Sukrugj i Malësisë së Madhe, i cili punonte në katin e 107 të njërës nga kullat binjake. Ai u ndodh dy herë në aktet terroriste të këtyre kullave, një herë në 1993 kur ato u sulmuan me bombë nga terroristët, por ai vetë nuk pësoi gjë dhe me 11 Shtator 2001 ku gjeti vdekjen në punë e sipër si një hero i vertete.

Mon Gjonbalaj ishte 65 vjeç, nga fshati Vuthaj i Kosovës dhe që punonte në katin e 86-të të godinës nr 2, ku dhe gjeti vdekjen duke pastruar së bashku me shokët e tij zyrat e këtij kati.

Simon Dedvukaj ishte vetëm 26 vjeç, djalë i ri që punonte si përgjegjës në kompaninë e pastrimeve ABM të këtyre kullave në katin e 27-të. Simoni ishte një djalë shumë i mire dhe i edukuar e i shkolluar siç i ka hije një njeriu. Ai kishte vetëm një vit që ishte martuar.

NUMRI I VIKTIMAVE SIPAS VENDEVE TË NDRYSHME TË BOTËS

Nr.	Shteti	Nr. Viktimave	Pr.
1	Shqipëria	3	3
2	Argjentina	4	7
3	Australia	11	18
4	Bangladesh	6	24
5	Bjellorusi	1	25
6	Belgjika	1	26
7	Bermuda	1	27
8	Brazili	3	30
9	Canada	24	54
10	Kili	3	57
11	Kina	3	60
12	Cote d'Ivoire	1	61
13	Kolombia	17	78
14	Republika Demokratike e Congos	2	80
15	Republika Domenikane	47	127
16	Ekuadori	3	130
17	Elsalvador	2	132
18	Etiopia	2	134
19	Franca	3	137
20	Gjermania	11	148
21	Kana	2	150
22	Guana	3	153
23	Haiti	2	155
24	Honduras	1	156
25	India	41	197
26	Indonezia	1	198
27	Irelanda	6	204
28	Izrael	5	209
29	Itali	10	219
30	Xhamaika	16	235
31	Japonia	24	259
32	Jordania	2	261
33	Libani	3	264
34	Lituania	1	265
35	Malajzia	3	268
36	Meksika	16	284
37	Moldavia	1	285
38	Hollanda	1	286
39	Zelanda Re	2	288
40	Nigeria	1	289
41	Pakistan	8	297
42	Peruja	5	302
43	Filipines	16	318
44	Polonia	6	324
45	Portugalia	5	329
46	Rumania	3	332
47	Rusia	1	333
48	Afrika Jugut	2	335
49	Koreja Jugut	28	363
50	Spanja	1	364
51	Suedia	1	365
52	Zvicra	2	367
53	Taivani	1	368
54	Timidad dhe Ttabogo	14	382
55	Ukrahina	1	383
56	Mbreteria Bashkuar	67	450
57	USA	2606	3056
58	Uzbakistani	1	3057
59	Venezuela	1	3058

LETRAT

Dy tregime nga Sakip Cami

BRATKO

Të nesërmen e tërheqjes së trupave serbe nga malsia e Dibrës, malsori Besim Guri, shkoi në malin e Dethit, aty ku një ditë më parë zhvilloheshin luftime. E hante meraku se mos kishte mbetur ndonjë i plagosur nga shokët dhe të bënte një rrugë e dy punë, të ngarkonte dhe një mushkë me dru për familjen. Tymi në Malin e Dethit akoma nuk ishte shpërndarë. Era e djegieve, e barutit, e mishit të njeriut të plagosur nga plumbat ndjehej akoma. Plaga e plumbit të pushkës mban erë djegie dhe përcëllim. E ndjeu këtë erë Besimi, hapte sytë majtas djathtas se mos shihte ndonjë shok të plagosur, por dëgjoi një zë të mekur : Brat[1], brat..... I plagosuri, një serb i mbetur nga luftimet e djeshme lutej që të mos e vriste. Besimi që nuk dinte asnjë fjalë serbisht, fjalën brat e kuptoi si prat, mali i Pratit. Mirë, mor mirë se do të çoj në Prat. Meqë të fali plumbi, të fali Zoti, po të fal edhe unë, por ta dish mirë, or qen bir qeni se, po të ishte t'i në vendin tim, do të më shkoje në bajonetë që të kurseje edhe plumbin. Po unë nuk jam si ti, që vjen nga malet e tua dhe më sulmon në malet e mija, unë nuk jam si ti që vret gra e fëmijë, unë jam rob i Zotit dhe kështu të konsederoj edhe ty. Serbi i plagosur me duart lart e me të lutura pambarim i lutej të mos e vriste. Edhe sot mbeta pa çuar dru në shtëpi, mbetën fëmijët pa u ngroh se u bane sebep ti, mendoi Besimi. I dha forcë vehtes dhe e ngriti të plagosurin mbi samar të mushkës drejt shtëpisë së tij. Gruaja dhe fëmijët u habitën.

-Ç'e ke këtë mor burrë ? Edhe për këtë ishim mangut ne, i tha e shoqja. Ne nuk ngopim me bukë fëmijët dhe jo më të mbajmë serbin që vjen nga ana e anës për të na vrarë.

-Edhe ai është njeri si unë e si ti. E kanë detyruar dhe e kanë pru me zor me luftu. Ka edhe ai grua dhe fëmijë që e presin. E fali Zoti, e fala dhe unë.

Gruaja nuk bëzani. Fjala e burrit ishte ligj për të. Por më shumë e bindi urdhëri i Zotit.

Pasi e lanë dhe e veshën me rroba të tjera të përshtatura për trupin e tij, ja mjekuan plagën serbit me melhem plagësh.[2] Përgatitjen e melhemit Besimit ia kishte mësuar i jati të cilit ja kishte mësuar gjyshi i Besimit. Kishin bërë shumë beteja që nga koha e luftës kundër Hajredin pashës në Luginën e Drinit të Zi dhe melhemi kishte shpëtuar qindra jetë njerëzish luftëtarë. Serbit i thirrnin Bratko se ai vetëm brat thoshte. Pas një jave Bratkoja u shërua. Besoja e mori Bratkon për ta shoqëruar për në vendin e tij. Më parë shkuan në pazarin e Shehrit dhe i bleu një palë rroba të reja. E shoqëroi deri matanë Grykës së Radikës dhe i uroi rrugë të mbarë. Mos e kthe kokën këndej, e porositi, se nuk të fal më.

PLAKU DHE FLAMA

...Në fundin e vitit 1912 dhe fillimin e vitit 1913 u shfaq flama. Ishte një sëmundje e tmershme që transmetohej nga kafshët; bagëtitë dhe pulat, tek njerëzit. Populli e quante flamë sepse ishte vdekjeprurëse. I ngjante gripit apo rrufës siç e quante populli, por ishte shumë më agresiv se gripi. Njerëzit rrëzoheshin në tokë si pulat. I ka rënë flama, thonin njerëzit për të sëmurin dhe largoheshin prej tij. Mos e prek, mos e prek se të ngjitet sëmundja edhe ty. Në të vërtetë askush nuk e dinte se çfarë sëmundje ishte. Spitale dhe mjekë nuk kishte, as infermierë e ilaçe. Burrat, që kishin qenë ni-zamë dhe që kishin mësuar në ushtrinë turke, përdornin ato ilaçe e bimë mjeksore që kishin parë apo përdorur në luftëra e beteja. A ishte murtajë, kolerë apo fruth, askush nuk e dinte, askush nuk e diag-nostifikonte. Të gjithë e quanin flamë. Në atë vit vdiqën me mijëra shqiptarë, burra, gra e fëmijë.

Një plak i moshuar dhe i sëmurë me flamë qëndronte i shtrirë në shtratin e vdekjes. Vinin ta vizitonin dhe ta përshëndesnin pa u afruar, me shalla e breza në gojë e hundë për të mos u infektuar.

...Plaku lutej dhe kërkonte t'i sillnin pak turshi lakre se i kishte shkuar mendja dhe më pas të shkonte i ngopur në varr. Ngarendën shumë veta të gjenin e të kërkonin turshi, por ato ishin mbaruar. Vetëm një zonjë shtëpie kishte një fund shege me lëng turshish lakre e domatesh jeshile. I çuan një tas dhe e piu si i babëzitur.

Kërkoi prapë. I sollën përsëri E piu plaku fundin e shegës dhe filloi të përmirësohej. E vizitoi edhe një heqim që kishte studiuar në Stamboll për teologji dhe biologji. I treguan se çfarë kishte ndodhur. Më çoni tek ajo shtëpi se dua të shoh shegën e turshive, tha heqimi. I zoti i shtëpisë para dhe heqimi nga pas, arritën në shtëpi. Heqimin nuk e mbante vendi. Nuk dua të ulem, dua të shoh shegën, tha ai. Në shegë kishte mbetur vetëm një tas me lëng dhe një gjë ze zezë si bishti i bofçes. [3]

-Çfarë është ajo gjë e zezë, pyeti heqimi.

-E shkreta unë, ndoshta është bishti i bofçes që më ka ra brenda shegës, tha e zonja e shtëpisë e turpëruar.

-Nxirreni dhe ma jepni ta shoh, tha heqimi.

E nxorrën gjënë e zezë por ç'të shohin. Gjëja e zezë ishte një gjarpër i zi i ngordhur dhe i mbetur në fund të shegës.

-E shkreta unë, bërtita e zonja e shtëpisë, e tmerruar.

-Mos u merakos dhe mos u mjero. Ky gjarpër me helmin e tij të shpërndarë në të gjithë lëngun e turshive u ka shpëtuar juve nga flama dhe për fat edhe plakun në fund të katundit. E kam mësuar në Stamboll, shpjegoi heqimi.

Helmin e gjarpërit e përdorin për kundër helm. Njerzit për rreth mbetën gojë hapur. Mos u habisni, natyra i ka të gjitha bimët shëruese për njeriun, e mbylli fjalimin e tij heqimi si një dijetar i vërtetë.

PS:

[1] Brat, serbisht, vëlla

[2] Melhemi është pomadë që përgatitet me gjalpë të freskët dhe bimë mjeksore pylli.

[3] Bofçe është përparsja që mbajnë gratë zonja të shtëpisë gjatë gatimit she shërbimit.

20 vjet nga tragjedia amerikane e shembjes së kullave binjake

(Vijon nga faqja 6)

tagon por rrëzohet brenda saj;

Ora 10.00 e mëngjesit. Avioni United Airlines 93 që ishte nisur nga airoporti i Newark te New Jersey, për në San Francisco, California rrëzohet në Shanksville, Pennsylvania me 37 pasagjerë, 5 punonjës sherbimi dhe 2 pilotë në bord.Siç shihet, për 1 orë e 15 minuta rrëmbehen nga terroristet dhe rrëzohen 4 avionë pasagjerësh. Gjithsej jane vertetuar se kanë qenë 19 rrëmbyes terroristë, emrat e të cilëve janë të njohur por nuk po i shkruajme ne këtë artikull. Të gjithë terroristët, sipas të dhënave kanë qenë të shkolluar në akademitë e shkollave amerikane të aviacionit.

TREGUESIT E TRAGJEDISË SË 11 SHTATORIT 2001 NË SHIFRA E FAKTE

Më poshtë do të japim të gjitha të dhënat e ngjarjes dhe treguesit kryesorë, referuar agjencive të lajmeve, shfaqjeve online, librave të ndryshëm të botuar dhe të dhënave të Departamentit të Shtetit dhe të Higjienës së të qytetit të New Yorkut. Nga të dhënat dhe korrektimi i tyre vit pas vitit rezulton se nga kjo tragjedi kanë humbur jetën mbi 3058 qytetarë dhe janë lënduar mbi 60.000 qytetarë të tjerë nga plot 59 vende të ndryshme të botës dhe SHBA.

Nga këto, janë 1809 (60%) meshkuj me ngjyre të bardhe; 457 (15%) femra me ngjyrë të bardhë; 209 (7%) meshkuj hispanik; 102 (3%) femra hispanik; 161 (5%) meshkuj me ngjyrë të zezë; 99 (2.9 %) femra me ngjyrë të zezë; 147 (4.9%) meshkuj aziatikë; 74(2%) femra aziatike. Ndarja sipas ngjyrës nuk ka të bëjë me anën raciale por për saktësi njerëzore, prandaj lexuesi të mos na keqkuptojë për mënyrën e trajtimit.

Nga viktimat janë 1837 veta ose (60%) që kanë mbaruar shkollën e lartë, college dhe me grada shkencore dhe 1213 (40%) që kanë mbaruar shkollën e mesme. Viktimat janë të moshave të ndryshme, nga 2 deri 85 vjeç.

Gjithsej janë 2606 viktima nga 26 shtetet e ndryshme të SHBA, shumica e tyre nga Neë York dhe Neë Jersey dhe 452 viktima nga 58 shtetet e tjera të botës, të pasqyruar në tabelën përkatese. Nga viktimat, 12 janë gra me bebet e tyre 6 deri 10 muajshe që prisnin të lindnin, por që s'e panë dot dritën e diellit.

Fëmijët nën moshën 18 vjeç jane 8 veta.Viktima më e re është një vajzë 2 vjeëare, Christine Lee Hanson nga Graton, Massachusetts USA, pasagjere në avionin United 175 që goditi QNT (Qendrën Ndërkombëtare Tregtare). Viktima më e vjetër është Robert Grant Norton, 85 vjeç nga Lubec, Maine USA, pasagjer që udhëtonte me avionin AA 11.

Mbi 3251 fëmijë në botë atë ditë humbën njërin nga prindërit. Shumica e viktimave kanëe qenë në moshën më aktive për punë, nga 21 deri 62 vjeç që përbëjnë mbi 97 % ose 2979 veta.

Nga qyteti i Neë Yorkut janë 2823 viktima, nga të cilat 1102 veta janë te identifikuar të vdekur; 1571 janë me çertifikate vdekje dhe 150 janë ende të pa gjetur.

Nga gjithsej 343 zjarrfiksa, jane 192 te gjetur dhe 151 të pa gjetur.

Nga 23 policë oficerë janë gjetur 14 dhe të pa gjetur ende janë 9 veta. Nga 37 oficerë të airoportit, 20 prej tyre janë gjetur dhe 17 janë të humbur.

Nga punonjësit e emergjencave mjeksore janë gjetur vetëm 3 veta.

Në ëashington DC, Pentagon, nga 189 veta të vdekur janë gjetur 64 veta dhe janë të humbur ose të djegur 125 veta.

Në Pennsylvania kanë vdekur 44 veta.

Duke ngushëlluar gjithë familjet e viktimave dhe veçanërisht familjet shqiptare, mendoj se kjo tragjedi mizore do kujtohet brez pas brezi në historinë e njerzimit.

HOMAZH

LAMTUMIRË JORGJI TERCA!

Familjarë, miq, të afërm e bashkëpunëtorë të ngushtë përcollën sot për në banesën e fundit veteranin demokrat Jorgji Terca.

Ai kishte lindur në një familje patriotike tiranase 89 vjet më parë. Në këtë mjedis atdhetar u rrit dhe u edukua me dashurinë për familjen dhe atdheun. Ndaj dhe që në fëmijërinë e tij, kur ishte veçse 10 vjeç do të shprehte urrejtjen për pushtuesin fashist të vendit.., duke u bërë një nga anëtarët më aktiv të organizatës së njohur me emrin "DEBATIK".

Debatikasi Jorgji Terca mori pjesë në disa aksione luftarake kundër karabinierisë fashiste italiane, si ndërprerje linjash telefonike, rrëmbime pajisjesh propagandistike, municione e armatime. Aktivitetin luftarak e vazhdoi pandërprerë deri në çlirimin e plotë të vendit nga pushtuesi nazifashist.

Pas çlirimit, Jorgji shërbeu me devotshmëri e përkushtim në disa reparte të Ushtrisë Shqiptare.

I zhgënjyer nga sistemi i diktaturës që nuk ia njohu meritat, Jorgji do të mbështeste fuqishëm proceset demokratike pas '90-tës.

Që me krijimin e OBVL(Org.Bashkuar e Veteranëve) Jorgji u bë një nga anëtarët aktiv, përkrah themeluesve e drejtuesve të saj, si Dr.Ymer Dishnica, Gjeneral Rrahman Parllaku, Gjeneral Nexhip Vinçani e personaliteteve tjera të LANÇ e Ushtrisë Shqiptare, si: Liri Belishova, Edip Ohri, Skënder Malindi, Tahir Voshtina, Myfit Guxholli, Sotir Budina etj. Madje, prej dhjetë vitesh ai drejtoi degën e OBVL Tiranë, si kryetar i saj, duke organizuar veprimtari të larmishme me veteranët, si përkujtimore, vizita e ekskursione tek Llixhat "Nëna Naile" në Kosovë, në Voskopojë, Përmet, Ersekë etj, duke siguruar mbështetjen e donarëve të ndryshëm.

Ai ishte një prind dhe veprimtar shoqëror shembullor.

Si i tillë do të kujtohet e nderohet nga njerëzit e familjes, shoqëria dhe nga OBVL.

Në emër të kryesisë së OBVL i shprehim familjes të ndjerit ngushëllimet më të thella.

Lamtumirë miku ynë i shtrenjtë Jorgji Terca!

Parajsa qoftë vendbanimi yt i përjetshëm..

OPINION

Diplomatja këngë: "kënga Goettingen" që bëri historinë, ajo u bë simbol i bashkimit France-Gjermani.

Kënga Gottingen dhe debati në Rajonin e baltosur të Ballkanit...

Zaim KUÇI

Rikthehem në dhjetorin e debateve (2016) me presidentin e ri të SHBA, ku media u punësua mirë duke mbushur pambarim kohën televizive. Me ardhjen e Trump bota mediatike, por edhe ajo politike po trazohej. Dukej sikur ajo po rikërcënohej me duelet dhe sjelljet e përditshme midis Kimit, Putinit që për mua ishin tigër prej letre përballë Trump.

Deklarata të çuditshme nuk munguan dhe ato kundër Nato-s.

Në këtë bum informacioni lexova se një i afërt i Trump nuk e njeh luftën e Kosovës. Katastrofë ishte për mua ky lajm i cili më ngacmoi të mendoja keq për zhvillimet politike në vendin e aleatëve. Kjo ishte situata mediatike ne ate kohe.

Gjuha e ashpër e komunikimit në këtë botë të ç'orjentuar, çuditërisht u pasua me rritjen e buxhetit për mbrojtje, madje buxheti "Obama CARE" u kalua për programet bërthamore; nisën kontratat miljardere për shit/blerje armatimesh, a thua të jetë bërë zhurmë médiatike për këto shitje...?

Si ushtarak, me kohë e kam përjashtuar fjalën armë për zgjidhje konfliktesepse politika (edhe feja) i ngatërron popujt në emër të tyre, të kombit me terma nacionaliste.

Nacionalizëm do të thotë , - luftë.

E deshirueshmja, - Formimi im për zgjidhjen e një konflikti është sjellja në modelin kënga "Goettingen".

Jam mrekulluar kur kam lexuar për herë të parë për faktin që Kancelari i Gjermanisë Gerhard Schroder i ka përdorur fjalët e këngës në fjalimin e tij në takimin për paqe me Francën.

Nga ana e tij edhe Gjeneral Charles de Gaulle (de Gol) shkoi në qytetin gjerman Ludvigsburg dhe iu drejtua gjermanëve në gjuhën e tyre, sjellje që do të shënonte 40-vjetorin e Traktatit të Elizesë për pajtimin e dy shteteve.

Të dy udhëheqësit dolën përballë njëri tjetrit me fjalor paqeje, në një kohë kur plagët e luftës ishin ende të hapura.

Paqja erdhi, më tregoi një mik francez, kur akoma ndjehej era dhe tymi i kockave njerëzore, kur tmerret e luftës barbare ishin dhimbje, kur ne francezët dhe ata gjermanët nxorrën fëmijën nga barku i nënës me bajonetat e urrejtjes; ata ishin shumë, mijëra por dhe miliona të blagosur dhe të vrarë.....

Në këto dhimbje njerëzore Barbara hebre këndoi "himn paqeje" në gjuhën e ish-shtypësve të tyre.

Monik Serf autore e këngës "Goettingen", një hebreje me emrin artistik Barbara i bashkoi udhëheqësit e luftës të nxehtë me gjuhën e këngës. Ajo e kaloi periudhën e luftës në arrati për t'u shpëtuar nazistëve dhe ishte ajo që u këndoi atyre në gjuhën e tyre.

Për pajtimin e pasluftës midis Francës dhe Gjermanisë shumë besojnë se kënga "Goettingen" ishte po aq e rëndësishme sa dhe Traktati i Elizesë.

Disa nga vargjet e saj thonë:

"Sigurisht ne kemi Senën/ por, Zot, sa të bukur janë trëndafilët në Goetingen";

"A mundet që koha e urrejtjes dhe e gjakut/ të mos kthehet kurrë më/ sepse këtu ka njerëz që shumë i dua".....

"Isha një student i doktoraturës në Goentingen,- kujton Schroder kur ajo këndoi baladën që preku zemrat tona dhe shënoi fillimin e një miqësie të mrekullueshme midis vendeve tona".

Sa do desha që rajoni i vitit 2021 të rikthehet në vitin 1946, në atë vit ku miqësia midis dy popujve erdhi në një moment teje të vështirë, kohë kur gjaku i dy popujve derdhej ende rrëke në tokat respektive...

PANDEMIA

Apeli i mjekut kardiolog pas disa vëzhgimeve të kryera në Qendrën Shëndetësore Nr.4 Tiranë

Si ndikon Covid-19 në organet kryesore të trupit dhe pse duhet të vaksinohemi?!

Dr. Leonidha Peppo*

Çfarë konkluzioni mund të nxjerrim pas tre fazave të para të pandemisë COVID-19, nga kontaktet me individë të ndryshëm, duke përfshirë edhe miqtë e pacientet e mi, si edhe vehten time?

Po për situatën e vaksinimit anti - Covid?

Çfarë ndodh në të tilla raste?

Cili është afati i vaksinimit pas kalimit të COVID-19?

Dhe më kryesorja: A duhet të vaksinohemi?

Këto pyetje kërkojnë përgjigje sepse ka mendime subjektive dhe objektive, për perspektivën e afërt dhe të largët të efekteve të kësaj pandemie.

Që në fillim dua t'ju bëj të ditur që këto përfundime janë pas leximeve të shumta të publikimeve te studimeve të personaliteteve ndërkombëtare të agjencive serioze, pas punës së tyre studimore e eksperimentale, me përfundime të sigurta deri tani.

Ata që ndjekin përfundimet serioze e kuptojnë që shumë koncepte ndryshojnë, po ashtu masat dhe kujdesi ndaj individëve dhe popullsisë në përgjithësi. Gjithsesi ka tregues dhe mundësi më të përparuara që mbeten për t'u parë, sepse pritet të ketë zhvillime.

Le të ndalemi tek ato dukuri të konstatuara deri tani nga individët që kanë kaluar COVID-19. Kjo, nisur nga përvoja personale e përditshmërive të shumta në Qendrën Shëndetësore Nr.4, Tiranë, duke reflektuar edhe në qëndrimin e personelit tonë mjekësor.

Dukuritë më të shpeshta janë lëvizja e tensionit arterial në shifra dukshëm më të rritura se ato të zakonshmet, në individë pa mjekim ose me mjekim. Këto të shoqëruara me ankesat e zakonshme, por që iu shtohet edhe ana emocionale e cila është shkaktare e çlirimit të katekolaminave që rrisin tensionin e gjakut dhe rrahjet e zemrës, gjithashtu (përdorimi i kortizonikëve në mjekim), përgjegjëse për rritjen e shifrave të sheqerit në gjak.

Të gjithë mjekët e familjes në klinikën tonë thonë që janë shtuar në mënyrë të dukshme rastet me sëmundjen e diabetit dhe se tek ata që e kanë diagnozën e diabetit është rënduar sëmundja si pasojë e marrjes së barnave shtesë për kurimin e saj.

Duhet theksuar se në rastet tona kjo gjendje ka ardhur me origjinë pas 2-3 muajsh, duke hequr edhe mjekimet e shtuara. Pra është fakt tepër pozitiv për ecurinë e ndjekjes së tyre, për ata vetë por edhe për mjekimin shërues të caktuar.

Ndikimi i COVID - 19 është shfaqur edhe në ndryshime të sjelljes së atyre që e kanë kaluar këtë sëmundje. Kjo dukuri është me e pakët se tëk sëmundjet e tjera. Mendohet se sëmundja gjeneron mikrotrombule ne vazat që furnizojnë trurin, duke degjeneruar në demtim të qelizave të tij, por këto mendime me kalimin e kohës mund të ndryshojne, siç edhe kanë ndodhur gjatë këtyre muajve dhe viteve.

Kjo mbetet për t'u parë….

Por në kabinetin e kardiologjisë janë konstatuar dhe vërtetuar me vizita klinike e aparatura fenomene të aritmive të ndryshme, të marrjes së frymës nga komplikacionet që shkakton virusi mbi zemrën, siç është zmadhimi i zemrës, të shoqëruara me likid (lëng) në cipat e zemrës. Kjo ndodh me të gjitha llojet e viruseve, por që ky që ka dalë në modë së fundmi është më agresiv. Me kontrollet e vazhdueshme të zemrës është zvogëluar deri në kufinj normal dhe likidi (lengu) është tharë aty ku ka pasur. Kjo pasohet me gjendje klinike të përmirësuar të pacientit.

Kësksioj na u shtua optimizmi për të ardhmen shëndetësore të këtyre të sëmureve dhe na u rrit shpresa që mundimet e mjekëve të jenë të suskeshme.

Kemi edhe shfaqje të trombozave të vazave të mëdha si në tru, në zemër, në mushkëri, gjymtyrë dhe lëkurë që kërkojnë mjekim shtesë pasi rrezikojnë jeten apo invalidizojnë njeriun, duke shkaktuar pasoja psikologjike, financiare, kohore në atë vetë dhe familjen e shoqërinë.

Prandaj, ju lutem vaksinohuni me gjithë mundësitë që tani i kemi të mëdha.

Po përshkruaj në fund fenomenet madhore të prekjes së mushkërive, sëmundja më e rëndë e prekjes nga coronavirus, shfaqjet e shenjave të shumëllojshme me rëndesa të ndryshme, nga më e lehta e deri tek e rënda, si dhe humbje jete edhe ne mes personelit mjekësor dhe shëndetsor. Me të dukshme kanë qenë prekja e mushkërive në drejtim të fibrozes apo pneumonia me prekje të cipave të tyre, me grumbullim likidi, me ulje te ngopjes me O2 dhe rritje të rrahjeve të zemrës. Mjekimi i tyre i vështirë shpeshherë i tepruar dhe i panevojshëm, ka dëmtuar shëndetin dhe financat familjare. Oksigjenoterapia është kryesore në mjekimin e patologjive të mushkërive. Duhet theksuar se komplikacioni kryesor është tromboza e vazave pulmonare me shenjat e njohura dhe të shkruara gjeresisht. Ka patur raste të analizave të gjakut të ndryshuara, siç është D - dimeri mbi normë, monocitet e larta, limfocitet e ulura , O2 i ulur në gjak, me mjekim të shtuar të përshkruar me kujdes dhe ndjekje mjekësore nga personel të specializuar. Prandaj për të mos arritur në këtë gjendje duhet të vaksinohen të gjithë me detyrim.

Ka gjithashti raste kur thuhet se vaksinimi anti-covid është me dëshirë, se gjoja preken liritë individuale dhe të drejtat e njeriut. Këto janë spekulime dhe çudira dhe pasojat do të jenë tek të pavaksinuarit, te fëmijët e familjarët e tyre, apo dhe shoqerisë rreth tyre.

Nëqoftëse personi i pavaksinuar ia ngjit këtë sëmundje vdekjeprurese dhe invalidizuese, pa diskutim kriminale, dikujt tjetër nga kontaktet në mhjedise publike, ç'duhet bërë athere? Ai duhet marrë në përgjegjësi penale, pasi i prek një perasoni tjetër apo dhe shoqërisë të drejtën për të jetuar, Ndaj dhe një person i tillë dyuhet dënuar penalisht, por edhe shoqërisht.

Pretekste të tilla të shfaqura nga individë të papërgjegjëshëm, se me vaksinimin vendosin cip në trup për të kontrolluar personalitetin janë sa humoristike aq edhe të çuditshme, ndërkohë që e gjithë bota e qytetarëuar njerezore i kërkon me ngulm vaksinat dhe vaksinimin si e vetmja mënyrë për të mos u infektuar nga COVID-19, ose për ta kaluar sa më lehtë atë. Gjithsesi, mbrojtja nuk është absolutisht e sigurtë. Rastet e reja me variantin DELTA, sipas Prof.Silva Bino tregojnë se 2-3 % infektohen të vaksinuarit me 2 doza dhe 10 % ata me 1 dozë të saj. Këto të dhëna, të publikuara deri tani janë ndërkombëtare. Të presim çfarë të rejash do të kemi në të ardhmen. Por e sigurtë është që vaksinimi duhet bërë.

Kardiolog, Qendra shëndetësore Nr.4, Tiranë

LIBRI

Tit Livi: "E vërteta mund të errësohet për një kohë, por kurrë nuk shuhet"

URAN KALAKULLA, NJË JETË VUAJTJE DHE DINJITET NJERËZOR

Duke parë se "Shqipëria e viteve 60 - të ishte e gjitha një dëshpërim, Urani, që komunizmin e quante një fatalitet historik, së bashku me shokë të tjerë si Pjetër Arbnori, Agim Musta, Tanush Kaso etj. në ilegalitet të plotë dhe me një guxim të pabesueshëm, po të kemi parasysh kohën, formuan një grup opozitar

SHPENDI TOPOLLAJ

Uran Kalakulla, vdiq gati pa pritur në një ditë pranvere. Në jetë kishte vuajtur shumë, por kurrë nuk qe thyer. Pas përmbysjes së diktaturës, me shkrimet dhe librat e botuara, u bë një figurë mjaft e njohur. Personalisht jam i lumtur që këtë luftëtar të lirive dhe të të drejtave të njeriut, e kisha mik. Për cilësite e tij të jashtëzakonshme, karakterin, kulturën, qartësinë e ideve, dashurinë për atdhe; pra për këtë demokrat të kulluar, po të më qe dhënë mundësia, në varrimin e tij do të kujtoja fjalët e paharruara që Hygoi tha për vdekjen e Volterit: "…Me qënë se nga fronet vjen nata, le të vijë drita nga varret." Dhe jam plotesisht i bindur se duke thënë kështu, nuk do të gaboja aspak. Edhe te grekët e lashtë Urani personifikonte Perëndinë e Qiellit, prej nga toka merrte dritën. Por në jetë, ashtu siç ndodhte shpesh në mitologji, ata që synonin të shpërndanin dritën për të tjerët, vetë ndëshkoheshin me errësirë.

Librin e tij "21 vjet burg komunist" që më dërgoi e lexova duke kujtuar se ai njëherë më pat thënë që "shumë krime u bënë te ne. Por ajo që ngjau qe edhe një provë e madhe e atyre që vuajtën. Burgu tregoi karakterin e secilit. Pati nga ata që hynë me dinjitet dhe dolën prej tij akoma më dinjitozë. Lum ai që arriti të shpëtoje shpirtin". Uran Kalakulla, siç del gjatë gjithë librit, mbeti aq i paprekur në nderin e tij, sa ai vlerëson pa drojë të tjerët, qofshin të dënuar, qofshin ruajtësit e tyre.

Ai shkruan: "Kur ndodhet para rrezikut njeriu, dhe ai me pak trimi, po të ketë disi dinjitet në veten e tij, shtrëngon dhëmbet dhe mundohet ta shohë në sy rrezikun, duke u munduar t`i bëjë ballë, apo të paktën ta durojë a sa të jetë e mundur më mirë. Ajo trimëria klasike apo romantike e kalorësve të lashtësisë apo të mesjetës, më duket se ka perënduar prej kohësh dhe nëse ka qënë ndonjëherë e vërtetë. Kështu kam pasur prej kohësh dhe vazhdoj të kem mendimin se trimëria e vërtetë nuk është aspak te shpata e muskujt e bështëm të trupit, por te zemra e shpirti i tij. Kam parë gjatë kohës së burgut jo burra, por meshkuj, që kishin alamet fiziku dhe para një kapteri xhuxh dhisnin gjak! Ashtu siç kam parë djem, që fizikisht jo vetëm që ishin mesatarë e nganjëherë të dobët, aq sa një erë e fortë mund t`i merrte me vete, por kur vinte puna para rrezikut e mundimit shtrëngonin dhëmbët dhe qëndronin si burra të vërtetë".

Koincidoi që librin e Uranit "21 vjet burg komunist" e lexova fill pas librit të bujshem te F. M. Dostojevskit "Shënime nga shtëpia e të vdekurve". Cilido lexues që ka një farë formimi letrar, do të shohë se kam shumë të drejtë që them se vuajtjet në burgjet e periudhës komuniste në Shqipëri, janë shumë më të rënda se ato të burgjeve të kohës së Carit në Rusi, dhe se Uran Kalakulla ynë, s`bie aspak më poshtë në të përshkruarit artistik të tyre, se vetë gjeniu rus. Ai është një mjeshtër i jashtëzakonshëm i penës.

Analizat dhe përshkrimet e tij, janë të paqortueshme, aq sa vetiu të lind pyetja:



Uran Kalakulla lindi më 1929 në Tiranë dhe u rrit në gjirin e një familje intelektuale. Pas përfundimit të fakultetit gjuhë-letërsi në Universitetin e Tiranës, ai punoi si arsimtar në disa rrethe të vendit deri më 1961 kur u dënua fillimisht me vdekje e më pas me 25 vite burgim për krijimin e grupit nismëtar të një partie politike klandestine me orientim social-demokrat europian.

I liruar më 1982, pas 21 vitesh burgim, kryesisht në burgun e Burrelit, u internua familiarisht pak më pas në zonën e Kryevidhit (Kavajë) prej ku u lirua në fund të vitit 1988. Që nga viti 1991 mori pjesë aktive në formimin e Shoqatës së të Dënuarve e të Përndjekurve Politike dhe në mjaft veprimtari të tjera politike në mbështetje të vendosjes dhe konsolidimit të Demokracisë në vend.

Gjatë viteve 90 botoi në shtypin periodik shumë shkrime me karakter politik, social e kulturor. Ndër veprat e botuara sa ishte gjallë spikasin vëllimi poetik "Vargje në Pranga", eseja politike "Shqiptarizmi dhe Prirja e tij Europeiste", monografia "Arshi Pipa, Njeriu, Jeta dhe Vepra". Pas vdekjes së tij në maj të vitit 2001 dolën në dritë vëllimet e tij autobiografikë "Njëzet e Një vjet Burg Komunist" dhe "Kur Isha i Vogël".

Përse i duhej bërë një dëm kaq i madh kulturës tonë, duke mbyllur në qelitë e ftohta, talente kaq të fuqishme. Duke parë se "Shqipëria e viteve 60 - të ishte e gjitha një dëshpërim, Urani, që komunizmin e quante një fatalitet historik, së bashku me shokë të tjerë si Pjetër Arbnori, Agim Musta, Tanush Kaso etj. në ilegalitet të plotë dhe me një guxim të pabesueshëm, po të kemi parasysh kohën, formuan një grup opozitar, kryetar i të cilit u zgjodh Urani.

Ky grup kishte një program, i cili synonte atë ideologji që do t`i çonte në një pozicion mes të majtës ekstreme dhe të djathtës ekstreme. I kishin hyrë një pune edhe pse përsërisnin herë pas here një thënie të Çernishevskit, se në regjimet popullore politika nuk është një shetitje më biseda të kendshme në bulevardin "Nevskij", por është në burg, tortura, plumba dhe litar

Dhe ashtu doli vërtetë. Më 27 Maj 1961, ata, në rrethana ende të paqarta, u arrestuan. Dënimi dihej: Ai dhe Pjetër Arbnori me vdekje, të tjerët me afate të gjata burgimi.

Të flasësh për llahtarinë e burgjeve shqiptare të kohës së diktaturës, nuk thua ndonjë gjë të re. Janë me dhjetra e qindra dëshmitarë që kanë treguar e përshkruar fytyrën e vërtetë e çnjerëzore të tyre. Urani ka marrë përsipër diçka më shumë. Ai zbërthen karakteret njerëzore pasi "Laryshia e botës njerëzore bie fort në sy, më mirë se kudo tjetër në burg. Dhe, për pasojë, askush nuk është hero kur bie në burg, por mund të bëhet atje, ose mund të shkojë drejt skajit tjetër, pra nga njeri në vemje, në një krimb qe tërhiqet rrëshqanë, vetëm e vetëm, që të mund të shpëtojë ekzistencën e tij njerëzore. Kështu, për pasojë burgu ka dy fakultete atë të nderit dhe të burrërisë dhe atë të turpit dhe poshtërsisë". Të kalosh plot 21 vjet mes kapterrëve dhe minjve të gjirizeve, nuk i thonë shaka. Siç nuk është shaka dhe qëndrimi i lidhur me pranga "gjermanesha". Por më shumë se sa dhimbjet fizike, Urani përshkruan gjendjen psikologjike. Në këtë fatkeqësi që e ka gjetur, në një moshë fare të re, ai çuditërisht kupton se nuk ndien aspak frikë. Brënda vetes së tij ai ndihet stoik. Ai ndiehet krenar që ideja për t`a pritur të pashmangeshmen me qetësi, gjakftohtësi, kurajo e dinjitet, e shoqëron edhe brënda dhomës së vdekjes.

"Dëshpërimi, leqendisja, lotët, të qarat e të thirrurat si prej gruaje, më janë dukur (në raste të tilla), jo vetëm shenja të një paaftësie absolute të vetes për t`u përmbajtur, por të një dobësie të tillë që i ka rrënjët sa në një dashuri të pafund ndaj vetes (e, për pasojë, edhe një dhëmbshurie e tejskajshme), aq dhe nga mungesa absolute e seriozitetit dhe respektit për vetveten." Vetë ai e pret vdekjen si në legjenda. Nga që e di se ditën nuk vinë për ta marrë e për ta ekzekutuar, bën si bën mes sfilitjeve, e pushon pak. Kurse natën qëndron në këmbë, me fytyrën e kthyer nga dera, që kur ta hapnin, ta gjenin përballë, të gatshëm e jo ta hiqnin zvarrë. Ai e priste vdekjen ashtu si Mersoi i Kamysë, i cili veçse uronte që ditën e ekzekutimit të tij të kishte sa më shumë njerëz, paçka se ai po dënohej i akuzuar për vrasje, por në të vërtetë s`kish bërë asnjë krim, vetëm se nuk kish qarë në varrimin e së ëmës.

"Pastaj, - shkruan ai - kisha vendosur të hidhja disa parulla që të dëgjonin të gjithë të dënuarit. Sa të më hante gryka, ashtu si dhe para skuadrës së push-katimit". Në jetën e përditshme njeriu e ka shumë më të lehtë të ruajë dinjitetin e vet. Ka shumë gjëra që për t`i bërë, a për t`iu shmangur, e ka ai në dorë.

Kurse në burg, puna ndryshon. Je i mbikqyrur në çdo hap, i izoluar nga bota, i detyruar të zbatosh urdhrat e të tjerëve, shpesh edhe të injorantëve, s`u bën dot bisht provokimeve e ngacmimeve. Pa dashjen tënde, mund të bëhesh pre e sherreve, e zënkave pafund. Të fyejnë e të poshtërojnë, të fusin për hiçmosgjë për një muaj në birucë. Por dhe kur ti numëroje edhe orët që të kishin mbetur për t`i kaluar në ate ferr, mund të të ridënonin pa të keq me pesë, me gjashtë, me shtatë, me tetë, me nëntë e me dhjetë vjet burg të tjera. Bile, mund edhe të të vrisnin fare e të të linin pa varr, qe të të mos të gjendej as nami e as nishani. E në këto kushte, i shkreti njeri, është në hall. Të ulë kurrizin? Të serviloset? Të provokojë e spiunojë të tjerët? Pra, të humbë nga vetja diçka shumë të vyer: nderin, që më pas nuk ke se ku ta gjesh? Tani zgjidh e merr. Dhe Urani diti të zgjedhë, ndaj nuk kurseu askënd, si ata që ulën kurrizin, e u bënë dëm shokëve, si xhelatët që quheshin prokurorë, hetues, gjyqtarë, komandantë burgu, operativë e deri gardianë. Të tërë s`ka pse t`i ruajë. I përmend me emër e mbiemër, në të kundërtën përgjegjësia e krimit do shpërndahej ose vetë ai do të mbetej anonim. Në këto raste pena e Uranit është e hidhur.

Dhe sa e këndshme bëhet kjo penë kur flet për një superintelektual, që i bën nder gjenit shqiptar, si Mustafa Bajraktari, të cilin e kishin përplasur si shumë të tjerë, në burg.

Për atë që s`ka qënë ndonjëherë në burg, është e vështirë ta besojë se atje ka një pafundësi tipash e ndodhish, për të mos thënë një univers i tërë. Pikërisht këtë univers na jep Uran Kalakulla. Çdo kapitull do të qe më se i mjaftueshëm për të shkruar skenarin e një filmi mbresëlënës. Libri "21 vjet burg komunist" përbën ndofta më mirë se çdo libër i llojit të tij enciklopedinë e burgut. Parakalojnë para syve të lexuesve, trima e frikacakë, xhelatë e viktima, besnikë e të pabesë, të mirë e të liq. Shohim aty grupin e pleqve të burgut, të rënët nga fiku, njerëzit e zotit, shkrimtarë e "doktrinarë" marksiste, të huaj që besonin te "parajsa" shqiptare, por dhe horrat e burgut.

Duke u marrë me këta, si dhe me gjeneralët e zinj e prokurorët e kuq, të cilët sot duhet të turpërohen me ato që kanë bërë, Uran Kalakulla, i bën një shërbim të madh historisë tonë. Ai tregon se si duhet shkruar e vërteta dhe u jep një goditje përfundimtare të gjithë atyre që thonë se u lodhëm me letërsinë e burgut.

Urani sikur u thotë atyre: Ju nuk u lodhët njëherë për të na nxirë jetën ne, dhe mërziteni vetëm pse ne shkruajmë përsa kemi parë e hequr në kurrizin tonë? Ata duhet ta dinë thënien e Tit Livit se "E vërteta mund të errësohet për një kohë, por kurrë nuk shuhet".

LIBRI

Dritare e hapur për të mundësuar shpalljen me titullin e lartë "Dëshmor", të gjithë të rënët e Shqipërisë

DËSHMORËT NË RRËNJËT E KOMBIT SHQIPTAR

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

(Vijon nga fq.1)

Nëpërmjet këtyre vëllimeve do të dokumentohet heroizmi, gjaku dhe kontributi i tyre të dhënë për Atdhe. Vëllimi u përgatit nga Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi, i cili ka bërë një punë të lavdërueshme për grumbullimin, sistemimin dhe pasqyrimin e të gjithë veprimtarisë së dëshmorëve të Atdheut nga viti 1848 që janë të dokumentuar dhe deri në ditët e sotme. Falënderimi shkon dhe për redaktorët e sidomos për Pandeli Koçin, i cili ka bërë një punë për t'u admiruar. Dihet nga të gjithë, edhe në botë se dëshmorët janë vlera të përhershme të kombit, pasi ata kanë dhënë jetën për atdheun, për idealet e larta shqiptare, prandaj edhe mirënjohja për gjakun e derdhur është nderim në përjetësi, për aktin sublim të rënies për atdhe.

Fjala "Dëshmor" është një emër i ndritur për popuj e kombe kudo në botë. Dëshmorët nuk janë numra apo shifra, por vlera e tyre është hyjnore, nderimi e mirënjohja nuk mbetet vetëm në pllaka varresh, në lapidarë e memoriale. Ndaj dhe për këto vlera të spikatura kombëtare ruhen në zemrën e kombit. Dëshmorët janë pasuri që lidhin brezat e kombit shqiptar, janë trashëgimia e ndërgjegjes kombëtare, vlerat dhe virtytetet e krenarisë, materie e ndërgjegjes së kombit që lidhin të djeshmen me të sotmen, prandaj në gojën e popullit është materializuar me shprehjen "pa të shkuar nuk ka të ardhme".

Nëpërmjet një parathënie të gjatë dhe të saktë të bërë nga Prof. Zaho Golemi, dëshmohet se dëshmorët, me gjakun që derdhën në themelet e kombit, i ndihmojnë dhe do t'i ndihmojnë përherë të gjallët e këtij kombi që të shikojnë rrugën e drejtë dhe të vërtetë se nga duhet orientuar dhe ecur edhe në kohrat më të turbullta e komplekse. Në parathënie libri thekson se Ligjit 109/2018, datë 20.12.2018 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", po bëhet një dritare e hapur për të mundësuar shpalljen me titullin e lartë "Dëshmor", të gjithë të rënët e Shqipërisë, që nuk janë ende të evidentuar, për mbrojtjen e truallit arbëror. Në mbarë botën ka nderime në forma e metoda nga më të ndryshmet, jo vetëm me një ditë përkujtimore në vit, por edhe me veprimtari që sjellin në vëmendjen e brezave atë të shkuar heroike, për të qenë të lirë, në emër të idealeve të mëdha, si dhe në emër të kombit dhe për kombin. Prandaj edhe publikimi i këtij libri risjellë në vëmendjen e gjithë shoqërisë shqiptare ato periudha vitale uniteti kombëtar të përbashkuar për lirinë, për të sotmen dhe për të nesërmen.

Nëpërmjet një parathënie të gjatë dhe të saktë të bërë nga Prof. Zaho Golemi, dëshmohet se dëshmorët, me gjakun që derdhën në themelet e kombit, i ndihmojnë dhe do t'i ndihmojnë përherë të gjallët e këtij kombi që të shikojnë rrugën e drejtë dhe të vërtetë se nga duhet orientuar dhe ecur edhe në kohrat më të turbullta e komplekse. Ata i thërret në ras rreziku, sikurse çdo njeri thërret në situatat më të vështira të jetës, duke lutur "zemerekun e jetës", ku në formatin ideal të besimit, çdo shqiptar thotë: "O Nëna ime Shqipëri!".

Libri ka vlera kombëtare sepse aty do të gjenden të detajuar historite dhe luftërat e zhvilluar në shekuj nga kombi shqiptar, por dhe dëshmorët e rënë në emër të ruajtjse së territorësisë dhe të unitetit të kombit shqiptar. Libri nuk ka një rrjedhshmëri logjike duke filluar nga dëshmorja e parë e Atdheut e shpallur juridikisht deh vazhdon gjatë gjtihë historisë së kombit tonë. Është një përshkrim dinjitoz dhe i menduar mir, ndaj lexohet shpejt dhe në kujtesë thërritet të gjtihë dëshmorët të cilët i vunë gjoksin Atdheut për lirinë.

PËRMBAJTJA E LIBRIT

Libri fillon me Maro Kondi, dëshmorja e parë e Shqipërisë e vitit 1847, pasta më tej rreshtohen sipas ngjarjeve dhe ndodhive Rrapo Hekali një fgurë e shquar e kryengritjes fshatare, Emër i shquar në hisorinë e kombit shqiptar, ata që dëshmuan hisorinë e sakrifcave të shqiptarëve në kohë pushtimi, burri që i foli kohës me grykën e pushkës, Sulejman Vokshi figurë e ndriture Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Spiro Bellkameni, atdhetar dhe luftëtar i vendosur, Kryengritja e Malësisë së Madhe dhe dëshmorët e saj (1911), Atdhetari, dëshmori Kadri Gjata dhe roli i tij në klubin e Janinës, Beteja e Lumës dhe dëshmorët e saj, Ramadan Zaskoci fgurë me përmasa kombëtare, Çerçiz Topulli dhe çeta - flamur lirie Dedë Gjon Luli - hero i shquar i kombit shqiptar dhe pushkë e ngrehur për Shqipërinë, Isa Boletini - shqiptari që ngjallet gjithmonë, Atdhetari Atë Stath Melani – dëshmor i lirisë, Selam Musa Salaria në rrjedhat e lëvizjeve atdhetare, Elez Isuf - Gjenerali me shajak, Luigj Gurakuqi - atdhetar i shquar dhe dëshmor i çështjes kombëtare, Bajram Curri, komandant i talentuar popullor, Hasan Prishtina. Dëshmor dhe Hero i papërsëritshëm, Bota e madhe e Qemal Stafës, Kuçi bazë e sigurt e LANÇ-it me 90 dëshmorë, Kuçi me 90 dëshmorë dhe 4 heronj të popullit, Heronjtë e Shkodrës që bënë hisori, Vlora dhe heronjtë e Topanasë, Shtatë dëshmorët e Ngurrëzës, Gjaku i pafajshëm i popullit të Tiranës, Në Golëm në Labëri gjashtë dëshmorë nga një shtëpi, Nderim i përjetshëm për dëshmorët e rrethit të Përmetit, Myzeqarët krah për krah me LANÇ-in, Ali Demi, biri trim i Çamërisë, Masakra e 4 shkurtit '44 në dokumentet e arkivës gjermane, Malësia e Gjakovës, treva heroike që i dha kombit qindra dëshmorë, Trimi nga Smokthina në kujtesën e Atdheut, Lule, more trima, Kalendari i rënies së Dëshmorëve të Lushnjës, Dëshmorët e Elbasanit krenaria dhe lavdia e gjithë Shqipërisë, Komisari dëshmor Asllan Keta i Bulqizës ishte i dijes dhe i pushkës, Mallakasra, krahinë martire e LANÇ-it dhe e paqes, Gjaku i dëshmorëve të Tepelenës në themelet e Shqipërisë, Dëshmori Krisaq Capo – meteor i lirisë, Lufta e Pojskës dhe gjaku i dëshmorëve të saj, Mihal Pandeli Koçi në udhën e çelur të atdhetarisë, Vrasja e pabesë e heroit Bardhok Biba, Memo Nexhipi, dëshmori që shkroi hisori më 1949, Heroinat e Mirditës në luftë kundër reaksionit, Dëshmorët e Fushëbardhës në dy shekuj krenari e përligjur atdhetarie, Ne mbetëm kuftarë të përjetshëm, Dëshmorët në mbrojtje të rendit në Shqipëri, Të vdesësh me dashurinë e atdheut, Liria e Kosovës është larë me gjak të pasër arbëror, "Për Atdhe, gjuhën shqipe dhe flamurin kombëtar", Me pushkë e penë për Atdheun, Pesëmbëdhjetëvjeçari Enver Bytyçi dëshmor i kombit, Dëshmori Muharrem Hoxha – sudent i përjetshëm, Dëshmori që ka rënë atje ku rreh zemra e kombit shqiptar, Visar Sinani - dëshmor për kombin shqiptar.

KANË KONTRIBUAR ME SHKRIME

Për hartimin e këtij vëllimi të parë kanë ndihmuar me shkrime, letra dhe dokumente të ndryshme Zaho Golemi, Rami Memushaj, Albert Hitoaliaj, Bilbil Dervishi, Trifon Mersin Golemi, Irfan Iliaz Birbilaj, Shaqir Vukaj, Sotir Papuli, Shefqet Hoxha, Shaban Demiraj, Sazan Goliku, Dorian Koçi, Bardhosh Gaçe, Mehmet Prishtina, Nasho Jorgaqi, Dalan Buxheli, Bernard Zotaj, Naime Progonati, Xheladin Çelmeta, Xhevdet Shehu, Halil Katana, Myfit Poçari, Tomor Kotorri, Krenar Progonati, Anastas Gurma, Sokrat Ikonomi, Xhemil Xh. Çela, Marenglen Kasmi, Shpend Bisheva, Resmie Ruçi, Kozma Gjini, Xhulieta Graceni (Roseni), Bardhyl Toda, Aziz Keta, Shpëtim Dervishaj, Reuf Skënderaj, Bujar Sula, Jani Capo, Dhimitër S. Shuteriqi, Vasil Premçi, Gëzim Prengzi, Bekim Arapi, Flamur Hasimi.

NJOHJE ME ZAHO GOLEMI

Kolonel ® Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi ka lindur në tetor 1960 në Fushëbardhë të rrethit Gjirokastër. Ka përfunduar studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerave, Universitetin e Tiranës në degën Histori, Akademinë e Shtabit të Përgjtihshëm, Akademinë e Luftës Tokësore në Stamboll, Akademinë Diplomatike.

Mban gradë shkencore dr. dhe titull akademik Prof. Asoc. Ka kryer detyra nga komandant toge deri në komandant brigade, Drejtor Operacional në Forcat Tokësore, Drejtor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, Drejtor në drejtoritë e Shtabit të Përgjtihshëm, Dekan i Fakultetit të Sigurisë e Mbrojtjes etj.

Për punë të mirë në vite është vlerësuar me 11 urdhëra e medalje. Aktualisht punon në Akademinë e Sigurisë. Ka publikuar në shtypin e përditëshëm dhe në revista shkencore qindra artikuj; ka qenë pjesëmarrës në mjaft konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Ka publikuar disa libra, rregullore ushtarake, metodika në funksion të Forcave të Armatosura si dhe librin "Dëshmorët e Atdheut" me bashkëautorësi. Gjithashtu ka publikuar edhe mjaft artikuj për Dëshmorët e Atdheut.

FOTOREPORTAZH

Presidenti Meta vlerësoi me Dekoratën e lartë "Nderi i Kombit" (pas vdekjes), Komandantin legjendar të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

ME PROPOZIMIN E OBVL: GJENERAL NEXHIP VINÇANI "NDERI I KOMBIT"

10 Gusht 2021 - Presidenti Meta vlerëson Komandantin legjendar të LANÇ, Nexhip Vinçani me Dekoratën e lartë "Nderi i Kombit": "Merita dhe kontribute të shquara për organizimin dhe drejtimin e Luftës për çlirimin e Atdheut, për forcimin e Ushtrisë shqiptare, si luftëtar i përhershëm i lirisë dhe i demokracisë, si dhe njëri ndër themeluesit e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS

I jep

NEXHIP VINÇANIT (PAS VDEKJES)

DEKORATËN "NDERI I KOMBIT"

"Në vlerësim të kontributit të shquar në mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe tërësisë territoriale të shtetit shqiptar.
I dalluar për guximin, përkushtim dhe aftësi drejtuese gjatë LANÇ-it, si njëri prej luftëtarëve të parë të njësiteve dhe çetave partizane, deri komandant ushtarak i Brigadës IV Sulmuese.
Për cilësitë e spikatura në fuqizimin e modernizimin e ushtrisë shqiptare, për kurajën qytetare dhe mbështetjen e proceseve demokratike, si dhe njëri ndër themeluesit e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it".

Nr. Dekreti 13192
Tiranë, më 09.08.2021

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META